



Agjencia e Akreditimit e Kosovës
Kosovo Accreditation Agency
Agencija za Akreditovanje Kosova

Qendra e Studentëve, kati i II-të
10000 Prishtinë, Kosovë
Tel : +381 38 213-722
Fax:: +381 38 213-990
e-mail: kaaoffice@gmail.com
web: www.akreditimi-ks.org

Nr. 488/13 dt. 08.07.2013

Në mbështetje të nenit 145 (pika 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 4, 21, 22 të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr. 03/L-189), Ligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (nr. 04/L-037), neni 7 (pika 2.3 dhe pika 4), Udhëzimit Administrativ për Licencimin e BPrAL (nr. 25/2012), Udhëzimit Administrativ për Themelimin e AKA-së (nr. 11/2004), Udhëzimit Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (nr. 02/2013), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë i Agjencisë së Kosovës për Akreditim ka shqyrtuar raportet e ekspertëve të vlerësimit dhe në bazë të rekomandimeve, në mbledhjen e mbajtur më 3 Korrik 2013, ka marrë:

V E N D I M

I. Akreditohen programet e studimit të Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, të Universitetit të Prishtinës:

- Telekomunikacion (PhD) A
- Shkenca Kompjuterike (PhD) A

për një periudhë 3 vjeçare (1 Tetor 2013- 30 Shtator 2016).

II. Programi i studimit:

- Automatikë (PhD) A

për një periudhë 3 vjeçare, 1 Tetor 2013-30 Shtator 2016), me kushtin që të rekrutojë një profesor, i cili ka hulumtime gjithëpërfshirëse dhe publikime, para fillimit të ofrimit të programit.


III. Programet e studimit:

- Elektronikë (PhD) A
- Elektroenergjetikë Industriale (PhD) A
- Sistemet Elektroenergjetike (PhD) A

për shkak të duplikimeve të përmbajtjeve të kurrikulave nuk akreditohen. Rekomandohet të bëhet fuzionimi i programeve sipas rekomandimeve të Ekipit të Ekspertëve.

IV. Institucioni i juaj është i obliguar që të hartojë një Plan të Përmirësimit në bazë të rekomandimeve të dhëna nga Ekipi i Ekspertëve (në të dy gjuhët dhe në të dy versionet) dhe të njëjtin ta dorëzoni në Agjencinë e Kosovës për Akreditim gjer më 1 Dhjetor 2013.

V. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Dr.sc. Ferdije Zhushi Etemi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë